

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Itali/ Kapet me 414 kg kanabis shqiptari, droga kap vlerën e mbi 4 milionë eurove
ADRESA	https://lajmifundit.al/aktualitet/itali-kapet-me-414-kg-kanabis-shqiptari-droga-kap-vleren-e-mbi-4-mili-i1337934
BURIMI	lajmifundit.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 20:03:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 19:48:48 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	04a07831f47669ccf1b7a608fab2c42adfad67c152be9c14912baf1f48dc21f8
TEKSTI	cbc42fdf735315d6a3e9a722ee606d6435a2acd315402adeb536674bd0fbe364
PAMJA	630734c1fb155eaf38f3a6bb180d53ca22c466c5e5868c5815a7690a3096f487

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	381821c6367bbf4f3daa9c218d8cb881283ead72c791c2265893d6a4e70778ec
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	236eb96fe169b4692e142b22588aed50ca0b168d3e0d8d3c079cd404682cbd2f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/381821c6367bbf4f3daa9c218d8cb881283ead72c791c2265893d6a4e70778ec>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [Politike](#)

Itali/ Kapet me 414 kg kanabis shqiptari, droga kap vlerën e mbi 4 milionë eurove


Lexo lajmin e plote



Manekini që nxiti polemika, Çerçiz Topulli "shkarkon" kreun e ATK Gjirokastrër

Lexo lajmin e plote






Harta e re Territoriale votohet në 8 tetor, vetëm dy javë për diskutimin parlamentar

Lexo lajmin e plote




Putin paralajmëron Evropën: Na lini të jetojmë në paqe, përndryshe do të reagojmë

Lexo lajmin e plote



Kurti: Identifikohen tri viktime të `Grupit të Intelektualëve`

Lexo lajmin e plote



Itali/ Kapet me 414 kg kanabis shqiptari, droga kap vlerën e mbi 4 milionë eurove

 Lajmifundit / 19 Shtator 2026, 21:48
Shpërndaje
Aktualitet



Një 29-vjeçar shqiptar ka rënë në prangat e policisë italiane, pasi iu gjetën dhe sekuestruan mbi 414 kilogramë kanabis, me një vlerë të përlogaritur prej më shumë se 4 milionë eurosh.

Sipas mediave italiane, droga u sekuestrua në Guidonia dhe dyshohet se ishte gati për t'u shpërndarë në qendrat e trafikimit të drogës në Romë dhe në provincat përreth.

29-vjeçari u ndalua nga autoritetet teksa po përpiquej të ngarkonte disa valixhe të mëdha në bagazhin e automjetit të tij. Gjatë kontrollit, policia gjeti brenda valixheve rreth 98 kilogramë kanabis. Hetimi vijoi pas gjetjes së një grupi çelësash në posedim të të riut. Çelësat rezultuan se hapnin disa ambiente të përdorura si depo në zonën e Guidonias dhe Romës.

Gjatë kontrolleve në këto ambiente, përfshirë edhe një garazh, policia zbuloi pjesën tjetër të drogës. Një sasi e konsiderueshme ishte fshehur brenda frigoriferëve, të cilët ishin përshtatur për t'u përdorur si vende magazinimi.

Në ambientet e kontrolluara u gjetën gjithashtu materiale për paketimin e dozave të drogës, si dhe disa fletë të shkruara me dorë, ku ishin shënuar llogaritje dhe të dhëna për numërimin e lëndës narkotike. Autoritetet italiane vijojnë hetimet për të zbardhur rrjetin e trafikimit dhe destinacionin e saktë të drogës së sekuestruar.

MOTI NE TIRANE

[Tirana, Albania](#)

Politikë